

Jahja ibn Ali Haxhuri



PARIME

të dobishme



PARIME TË DOBISHME

Shejhu i nderuar Ebu Abdurrahman Jahja bin Ali el Haxhuri (Allahu e ruajt!)
Përktheu: Xhabir SHEME

Parathënie

Falënderimi i takon vetëm Allahut të Madhëruar. Vetëm Atë falënderojmë, Atij i kërkojmë ndihmë dhe falje të gjynaheve tona. I kërkojmë mbrojtje Allahut prej të keqes së vetëve (shpirtrave) dhe punëve tona të këqija. Atë të cilin e udhëzon Allahu, nuk ka kush e humb dhe atë të cilin humb Allahu, nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhurar tjetër me të drejtë, përveç Allahut, Një e i Pashoq, dhe dëshmoj se Muhamedi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) është rob dhe i Dërguari i Tij.

Teuhidi është detyra më e rëndësishme, qëllimi më madhor dhe nevoja më e domosdoshme në mënyrë absolute. Ai është qëllimi i vetëm për të cilin Allahu i Madhëruar i krijoi krijesat. Pra, i krijoi ata për vënien në jetë të Teuhidit (njësimit të Allahut). Allahu nuk i krijoi krijesat për t'u shumuar me ta prej pakicës apo që të krenohej me ta prej përlules dhe as për t'u pasuruar me ta prej varfërisë. I Lartësuar, i Pastër dhe i Panevojshëm për të gjitha këto është Allahu i Madhëruar.

"Dhe thuaj: "Falënderuar qoftë Allahu, i Cili nuk ka fëmijë dhe nuk ka për Të shok në sundim. Dhe sa i përket aftësisë, nuk ka nevojë për ndihmëtar. Dhe madhëroje Atë me madhërinë që i takon". {17, 111}.

Po ashtu Allahu i Madhëruar thotë:

"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre ndonjë furnizim e as dëshiroj të më ushqejnë ata. Vërtet që Allahu, Ai është Gjithë-furnizuesi, Zotëruesi i Fuqisë, më i Forti." {51, 56 - 58}.

Allahu i Madhëruar është i panevojshëm për krijesat e Tij. Ai është i panevojshëm për bindjen dhe adhurimin e tyre. Me të vërtetë, i Madhëruari i krijoi ata që ta njësojnë Atë, të jenë të dëgjueshëm ndaj Tij, ta adhurojnë dhe t'ia përkushtojnë fenë vetëm Atij, të madhëruarit. E që të gjitha këto nuk i bëjnë dobi Allahut të Madhëruar, pasi Ai është i Begatshëm, i Falënderuar (vetvetiu).

Atij nuk i bën dobi dëgjueshmëria e atij që i bindet dhe as nuk e dëmton Atë mosbindja e keqbërësit. Të madhëruarit nuk i bën dobi njësimi (teuhidi) i atij i cili e njëson Atë, ashtu siç edhe nuk i bën dëm mosbesimi i jobesimtarit dhe të bërit shok Atij nga ana e politeistit. I Madhëruari, i Cili thotë:

"Kush e udhëzon veten në rrugën e drejtë, ai e ka udhëzuar vetëm vetveten, e kush e humb (rrugën), ai e ka bërë humbjen kundër vetvetes..." {17, 15}.

Po ashtu thotë:

"... e kush nuk besoi, të keqen e mosbesimit e ka kundër vetes". {35,39}.

Pra, mosbesimi i jobesimtarit është në dëm të vetë atij, ashtu sikurse besimi i besimtarit, njësimi që ai i bën Allahut dhe bindja që tregon ndaj Tij është në dobi të vetë atij. Ndërsa për sa i përket Allahut të Madhëruar, Ai është i panevojshëm për robërit e Tij. Ai është i panevojshëm për bindjen e tyre, për adhurimin e tyre dhe për të gjitha ato vepra të cilat ata i bëjnë për t'u afruar tek Ai. Teuhidi është qëllimi parësor, pasi që të gjithë profetët u dërguan që të ftonin për tek ai.

Allahu i Madhëruar, për ata të cilët e zbatojnë teuhidin dhe përpiqen për vënien në jetë të tij përcaktoi lumturi në këtë botë dhe në botën tjetër. Pra, lumturia në këtë botë dhe në botën tjetër arrihet në varësi të zbatimit dhe vënies në jetë të Teuhidit. Pak më parë përmendëm Fjalën e Allahut të Madhëruar:

"Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e përzier me besim të kotë..." Pra, nuk e përzier njësimin e tyre me shirk. Ky është kuptimi i këtij ajeti.

"... atyre u takon të jenë të sigurt dhe ata janë të udhëzuar." {6, 82}.

Atyre u takon siguria dhe udhëzimi i plotë në dynja dhe në ahiret, si shpërblim për njësimin dhe besimin e tyre ndaj Zotit të madhëruar. Teuhidi bëhet shkak për shumë sjellje të lavdërueshme, rezultate të kënaqshme dhe dobi frytdhënëse në dynja dhe në ahiret, të cilat nuk mund të përmbliidhen dhe as të numërohen. Për këtë shkak, teuhidi është mirësia më madhore dhe supreme në mënyrë absolute. Nuk ekziston ndonjë mirësi e cila gëzon pozitë më të lartë, më madhore dhe më fisnike se teuhidi.

Për këtë arsye, suren En Nahl (Bleta), të cilën disa prej dijetarëve e emërtojnë "Surja e Mirësive", për shkak të përmendjes që Allahu i Madhëruar i bën shumë prej mirësive të Tij ndaj krijesave, i Madhëruari e ka nisur me përmendjen e mirësisë së Teuhidit.

"Erdhi (është afruar) caktimi i Allahut (Kiameti), pra, mos kërkonit ngutjen e tij! I Lavdishëm dhe i Madhëruar është Ai mbi gjithçka që ata i shoqërojnë (si ortakë). Me urdhrin e Tij ia zbret engjëjt me shpirt (shpallje) atij që Ai dëshiron nga robërit e Vet (duke thënë): "T'ua tërhiqni vërejtjen se nuk ka të adhuruar tjetër të merituar veç Meje. Pra, të më keni frikën." {16, 1-2}.

Pas kësaj, në këtë sure vazhdohet me përmendjen e shumë prej mirësive dhe begative, madje në të i madhëruari thotë:

"Po edhe nëse përpiqeni t'i numëroni mirësitë e Allahut, nuk do të mund të arrini t'i përcaktoni ato." {16, 18}.

Vetëm se mirësia më e madhe, padyshim, është ajo e cila përmendet në krye të kësaj sureje.

Teuhidi është kreu dhe hapësi i Kuranit, ashtu siç është edhe mbyllësi i tij. Pra, Kurani me teuhid fillon dhe po me teuhid mbaron. Madje, i gjithë Kurani është ngulitës dhe rrënjësor i teuhidit, ashtu siç ka thënë edhe dijetari i madh Ibnul Kajim (Allahu e mëshiroftë!) në librin e tij me titull "Mederixh es Selikin":

"Kurani fund e krye është ngulitës dhe rrënjësor i teuhidit, pasi ai ose është kallëzim i cili të njofton me Allahun dhe me Qenien e Tij si i vetmi Zotërues, të njofton me veprat e Tij, me emrat dhe cilësitë e Tij, e ky, pra, është teuhidi teorik, ose është urdhër për t'ia përkushtuar fenë vetëm Atij, për të qenë i zellshëm dhe zbatues i urdhërësave të Tij, e ky është teuhidi praktik. Apo është sqarues për atë çka Allahu i Madhëruar ka përgatitur si shpërblim për ata të cilët ia përkushtuan fenë Atij dhe ishin të zellshëm në bindje ndaj Tij. I tillë, pra, është shpërblimi dhe nderimi i atyre të cilët e posedojnë teuhidin. Apo është kallëzues për ndëshkimin, qoftë ai herët a vonë, të cilin Allahu i Madhëruar e ka përgatitur për ata të cilët nuk ishin të bindur ndaj Tij, që i shoqëronin shok dhe e mohonin Atë. E s'ka dyshim se i tillë është ndëshkimi i atyre të cilët nuk e zbatojnë teuhidin. Apo në të (Kuran) ka përmendje të xhenetit dhe zjarrit, ku vihen në dukje mrekullitë e xhenetit, të cilat janë shpërblimi i atyre të cilët e zbatuan teuhidin dhe agonitë e zjarrit, të cilat i përjetojnë ata të cilët e kundërshtuan atë..."

Kurani fund e krye bën thirrje për njësimin e Allahut dhe vënien në jetë të këtij Njësimi, dhe tërheq vërejtje prej të kundërtës se tij (shok-vënies), e cila është në kontrast me të. Prandaj, themi se është detyrë për të gjithë ne muslimanët që Teuhidit t'i kushtojmë rëndësi më tepër se çdo gjëje tjetër.

Ai për ne duhet të jetë më primari i të gjitha çështjeve dhe më kryesori ndër të gjitha preokupimet tona të rëndësishme. Për këtë arsye, thirrja e parë me të cilën profetët u drejtoheshin popujve të tyre ishte thirrja e tyre për tek njësimi i Allahut të Madhëruar

“Adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij” {23, 32}.

Të gjithë profetët të cilët Allahu i dërgoi tek popujt e tyre, thirrjen e tyre e nisnin duke ftuar për në njësimin e Allahut të Madhëruar. Veç kësaj, kur i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e nisi Muadhin për në Jemen, atij i tha:

"Le të jetë e para gjë për tek e cila do t'i ftosh ata dëshmia se s'ka zot tjetër të vërtetë veç Allahut."

Ndërsa në një transmetim tjetër, thuhet:

"Le të jetë e para gjë për tek e cila do t'i ftosh ata njësimi i Allahut (me adhurim)."¹

Teuhidi duhet të jetë pikënisja e të gjitha çështjeve dhe përfundimi i tyre, të dukshme apo të padukshme qofshin ato. Madje ai përbën themelin e lumturisë dhe sekretin e shpëtimit, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.²

Përkthyesi

¹ Do të vjen ky hadith i plotë.

² Shkëputur nga “Eksamu et Teuhid” e shejhut të nderuar Abdurrazak el Bedër.

Me emrin e Allahut, i Gjithëmëshirëshmi, Mëshirëploti!

Parathënia e autorit

Falënderimet më të mira dhe më të bukura i takojnë vetëm Allahut. Dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut të vetëm e të pashoqë dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij. E më pas...

Allahu thotë në Librin e Tij të Ndershëm:

أَمْ كُنْتُمْ شُهَدَاءَ إِذْ حَضَرَ يَعْقُوبَ الْمَوْتُ إِذْ قَالَ لِبَنِيهِ مَا تَعْبُدُونَ مِنْ بَعْدِي قَالُوا نَعْبُدُ إِلَهَكَ
وَالِهَ آبَائِكَ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ إِلَهًا وَاحِدًا وَنَحْنُ لَهُ مُسْلِمُونَ

“Apo ishit ju dëshmitarë kur Jakubit iu afrua vdekja? Kur ai u tha bijve të tij: “Çfarë do të adhuron pas meje?” E ata i thanë: “Ne do të adhurojmë *Ilahun* tënd (atë që adhuron ti, Allahun të vetëm), të Adhuruarin e baballarëve (paraardhësve tu), të Ibrahimit, të Ismailit, të Is`hakut, Një të Adhruar, Një e të Vetëm dhe vetëm Atij i nënshtrohem si Muslimanë në Islam.” (Bekare 133)

Saktësohet nga hadithi Ibn Abasit (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!) se ai ka thënë:

“Një ditë, isha mbas Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) kur ai më tha: “O djalosh! Po të mësoj disa fjalë: Ruaje Allahun dhe Ai do të ruajë ty. Ruaje Allahun dhe do ta gjesht Atë para teje. Nëse kërkon diçka, atëherë kërkoja Allahut. Dhe nëse kërkon ndihmë nga dikush, atëherë kërkoji ndihmë Allahut. Dhe dije se, sikur të mblidheshin të gjithë njerëzit e botës për të të bërë diçka të mirë, ata kurrë nuk do të kishin mundësi për të bërë mirë, përveç asaj që ka caktuar Allahu për ty. Dhe sikur ata të mblidheshin për të të dëmtuar me diçka, atëherë ata nuk do të mund të të dëmtonin përveç se me atë që ka caktuar Allahu për ty. Janë ngritur lapsat dhe janë tharë fletët.”

Ky ajet dhe hadith si dhe të ngjashëm me këta, janë themeli kryesor për mësimin e fëmijëve rreth temës së njësimin të Allahut të Lartësuar, mësimin e adhurimit të Tij, ruajtjen e kufijve që ka vendosur Ai, mbështetjen tek Ai dhe të qenit gjithmonë në dijeni se Ai na vëzhgon vazhdimisht si dhe besimin në *kaderin* (paracaktimin) se çdo gjë e mirë apo e keqe që vjen prej Tij. Ky është edukimi i saktë fetar, për të cilin shpresohet se, ai që

i përmbahet, ka për t'u bërë një nga robërit më të mirë të Allahut. E gjithë kjo më shtyu që të shkruaj këto fjalë të thjeshta e të përmbledhura për fëmijët e mi - Allahu i përmirësuesi ata dhe sjellte përmirësim nëpërmjet tyre - rreth parimeve të teuhidit, akides dhe fik'hut, duke iu bashkangjitur argumentet e tyre nga Kurani dhe Suneti. Shpresoj se Allahu do t'u bëjë dobi atyre si dhe të gjithë fëmijëve muslimanë nëpërmjet këtij libri. Allahu është Ai që jep suksesin!!

Shkruar nga: Ebu Abdurrahman Jahja bin Ali el Haxhuri
Rexheb 1425h

Parime të dobishme në teuhid:

1. Nëse ty të thuhet: [Kush të ka krijuar ty?](#)

Thuaj: Mua më ka krijuar Allahu. Po ashtu, Ai i ka krijuar të gjitha krijesat. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(اللَّهُ خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ) [الزمر: 62]

“Allahu është Krijuesi i çdo gjëje”

2. Nëse ty të thuhet: [Kush është Zoti yt?](#)

Thuaj: Allahu është Zoti im dhe Zoti i çdo gjëje. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

{قُلْ أَغَيْرَ اللَّهِ أَبْغِي رَبًّا وَهُوَ رَبُّ كُلِّ شَيْءٍ}

“Thuaj, a përveç Allahut të kërkoj zot tjetër ndërsa Ai është Zoti i gjithçkaje?”

3. Nëse ty të thuhet: [Për çfarë qëllimi Allahu të ka krijuar?](#)

Thuaj: Allahu na ka krijuar me të vetmin qëllim që ta adhurojmë Atë. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

{وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ} [الذاريات: 56]

“Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”

4. Nëse ty të thuhet: [Cila është feja jote?](#)

Thuaj: Feja ime është islami i vërtetë. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ الْإِسْلَامُ)

“Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami.” (Al Imran 19)

Po ashtu, fjala e të Madhëruarit:

(وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ)

“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur”.

5. Nëse ty të thuhet: [Kush është Profeti yt?](#)

Thuaj: Profeti im dhe Profeti i këtij umeti (populli) është Muhamedi, i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!).

Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(مَا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِنْ رِجَالِكُمْ وَلَكِنْ رَسُولَ اللَّهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ)

“Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve...” (Ahzab 40)

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(هُوَ الَّذِي بَعَثَ فِي الْأُمِّيِّينَ رَسُولًا مِنْهُمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَإِنْ كَانُوا مِنْ قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُبِينٍ)

“Është Ai që u solli të analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t’u lexuar atyre shpalljet e Tij, për t’i pastruar e për t’u mësuar Librin dhe Urtësinë, ndonëse ata më parë ishin vërtet në humbje të plotë.” (El Xhumua 2)

Po ashtu, fjala e të Madhëruarit:

(فَآمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ النَّبِيِّ الْأُمِّيِّ الَّذِي يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَكَلِمَاتِهِ وَاتَّبِعُوهُ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ)

“Prandaj, besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk di shkrim e lexim e që beson në Allahun dhe Fjalët e Tij! Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!” (El Earaf 158)

6. Nëse ty të thuhet: [Cila është detyra e parë për njeriun?](#)

Thuaj: Mësimi i teuhidit (njësimit) të Allahut të Lartësuar. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!), kur Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e dërgoi Muadh bin Xhebel për në Jemen, atij i tha:

((إِنَّكَ تَقْدُمُ عَلَى قَوْمٍ مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ، فَلْيَكُنْ أَوَّلَ مَا تَدْعُوهُمْ إِلَى أَنْ يُوحِدُوا اللَّهَ تَعَالَى))

“Ti ke për të shkuar tek një popull që janë prej *ehlul kitab*, prandaj gjëja e parë për t’i ftuar atë është që ata të njësojnë Allahut e Madhëruar.”³

7. Nëse ty të thuhet: [Cila është domethënia e dëshmisë “La ilahe il lAllah”?](#)

Thuaj: Domethënia e saj është: Nuk ka të adhëruar tjetër me të drejtë përveç Allahut. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(فَاعْلَمْ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ)

“Dije se nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Allahut!” (Muhamed 19)

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

³ *Mutefekun alejhi*. Ky është teksti i Buhariut

(ذَلِكَ بِأَنَّ اللَّهَ هُوَ الْحَقُّ)

“Sepse Allahu është e Vërteta (i vetmi që meriton të adhurohet)” (El Haxh 62)

8. Nëse ty të thuhet: **Cila është domethënia e dëshmisë “Muhamed Rasulullah”?**

Thuaj: Domethënia e saj është: Se ai është i Dërguari i Allahut për të gjithë krijesat, xhinët dhe njerëzit.

Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا كَافَّةً لِلنَّاسِ).

“Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin” Sebe 28

Prandaj është detyrë për të gjithë ne që t’i bindemi atij, t’i besojmë si dhe të largohemi nga çdo gjë që ai na ka ndaluar. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(قُلْ أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ)

“Thuaj: “Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit!” (En Nur 54)

Transmetohet nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((ما نهيتكم عنه فاجتنبوه وما أمرتكم به فأتوا منه ما استطعتم))

“Nga ajo gjë që unë ju kam ndaluar, largohuni prej tyre, ndërsa nga ato për të cilat unë ju kam urdhëruar, mundohuni që t’i veproni brenda mundësive.”

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

هَذَا مَا وَعَدَ الرَّحْمَنُ وَصَدَقَ الْمُرْسَلُونَ

“(Do t’u thuhet): “Ja, kjo është ajo që ka premtuar i Gjithëmëshirshmi. Të dërguarit kanë thënë të vërtetën!” (Sure Jasin 52)

9. Nëse ty të thuhet: [Cila është e drejta e Allahut ndaj robërve të tij?](#)

Thuaj: E drejta e Allahut ndaj robërve të tij është që ata ta adhurojnë Atë dhe t'i mos i shoqërojnë Atij asgjë. Argument për këtë është hadithi i Muadh bin Xhebel (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((حق الله على العباد أن يعبدوه ولا يشركوا به شيئا، وحق العباد على الله ألا يعذب من لا يشرك به شيئا)).

”E drejta e Allahut tek robërve është që ata ta adhurojnë Atë dhe mos t'i shoqërojnë Atij asgjë. Ndërsa e drejta e robërve tek Allahu është që Ai mos t'i dënojë ata nëse nuk i shoqërojnë Atij asgjë.”⁴

10. Nëse ty të thuhet: [Çfarë është shirku?](#)

Thuaj: Shirku është adhurimi i tjetër kujt përveç Allahut të Lartësuar. Çdo gjë që adhurohet përveç Allahut të Lartësuar dhe përkushtimi i saj për tjetër kënd përveç Allahut, ajo është shirk.

Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَاعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا)

“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)” (En Nisa 36)

11. Nëse ty të thuhet: [Cili është gjykimi për pikturimin e krijesave me shpirt?](#)

Thuaj: Pikturimi e krijesave me shpirt është prej gjynaheve të mëdha. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((إن أشد الناس عذابا يوم القيامة المصورون))..

⁴ Mutefekun alejhi

“Me të vërtetë njerëzit me dënim më të ashpër në ditën e Kiametit janë ata që pikturojnë.”⁵

Po ashtu, në hadithin të cilin e transmeton Ebi Hudhejfe (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka ndaluar nga ngrënia e asaj që fitohet nga shitja e qenit, nga ngrënia e asaj që fitohet nga dhënia e gjakut...dhe i ka mallkuar pikturuesit.⁶

Nëse ty të thuhet: Çfarë lidhje ka pikturimi e krijesave me shirkun? Thuaj: Me pikturimin e krijesave Allahut të Lartësuar i bëhet rivalitet në këtë gjë. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Aisha (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

أشد الناس عذابا يوم القيامة الذين يضاهون بخلق الله

“Me të vërtetë, njerëzit me dënim më të ashpër në ditën e Kiametit janë ata të cilët maten me krijimet e Allahut (për të bërë si ato).”⁷

Po ashtu, edhe hadithi të cilin e transmeton Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: Allahu i Madhëruar ka thënë:

((ومن أظلم ممن ذهب يخلق كخلقي...)).

“Kush është më zullumqar se ai i cili përpiqet të krijoj si krijesa ime...”⁸

12. Nëse ty të thuhet: [Cili është kuptimi i termit “adhurim”?](#)

Thuaj: Ai (adhurimi) është termi përmbledhës i çdo gjëje që Allahu e do dhe është i kënaqur.

⁵ Mutefekun alejhi

⁶ E ka nxjerr Buhariu.

⁷ Mutefekun alejhi

⁸ Mutefekun alejhi

Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

إِنْ تَكْفُرُوا فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ عَنْكُمْ وَلَا يَرْضَىٰ لِعِبَادِهِ الْكُفْرَ وَإِنْ تَشْكُرُوا يَرْضَهُ لَكُمْ

“Nëse ju e mohoni Atë, dini se Allahu është vërtet i pavarur prej jush. Megjithatë, Ai nuk është i kënaqur me mosmirënjohjen e robërve të Tij, por kënaqet me ju, nëse e falënderoni.” (Zumer 7)

13. Nëse ty të thuhet: [Ku është Allahu?](#)

Thuaj: Allahu është lart mbi qiell, mbi Arshin e tij. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(أَأَمِنْتُمْ مَنْ فِي السَّمَاءِ أَنْ يَخْسِفَ بِكُمْ الْأَرْضَ فَإِذَا هِيَ تَمُورُ)

“A jeni të sigurt se kush është në qiell nuk do ta bëjë Tokën t’ju kapërdijë, kur të fillojë të dridhet papritmas?” (Mulk)

Po ashtu, fjala e të Madhëruarit:

(الرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَىٰ)

“I Gjithëmëshirshmi mbi Fron u ngrit (si i takon Madhërisë së Tij).” (Ta Ha 5)

Si dhe hadithi i transmetuar nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((يُنْزِلُ رَبُّنَا تَبَارَكَ وَتَعَالَىٰ كُلَّ لَيْلَةٍ إِلَى السَّمَاءِ الدُّنْيَا حِينَ يَبْقَى ثُلُثُ اللَّيْلِ الْآخِرِ، يَقُولُ: مَنْ يَدْعُونِي فَأَسْتَجِيبَ لَهُ، مَنْ يَسْأَلُنِي فَأُعْطِيَهُ، مَنْ يَسْتَغْفِرُنِي فَأَغْفِرَ لَهُ)).

"Zoti ynë i madhëruar zbret çdo natë në qiellin e dynjasë, në një të tretën e fundit të saj (natës) dhe thotë: A ka ndonjë që më lutet, ashtu që Unë t'i përgjigjem atij? A ka ndonjë që kërkon prej Meje, ashtu që Unë t'i jap atij? A ka ndonjë që më kërkon falje Mua, ashtu që Unë ta fal atë?"⁹ Zbritja është nga lart.

⁹ Mtefekun alejhi

14. Nëse ty të thuhet: [A është Allahu me ne?](#)

Thuaj: Allahu i Lartësuar është me ne me dijen e tij. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنْتُمْ).

“Ai është me ju kudo që të gjendeni” (El Hadid 4)

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(وَهُوَ اللَّهُ فِي السَّمَاوَاتِ وَفِي الْأَرْضِ يَعْلَمُ سِرَّكُمْ وَجَهْرَكُمْ وَيَعْلَمُ مَا تَكْسِبُونَ)

“Ai është Allahu (i vetmi Zot i Vërtetë) në qiej dhe në Tokë; Ai di çfarë fshihni dhe çfarë tregoni, si dhe atë që arrini të fitoni.” (El Enam 3)

Ibën Kethiri ka thënë: "Me këtë është për qëllim se Allahu është Ai që di çdo gjë që është në qiej dhe çfarë ka në tokë, prej të dukshmes dhe të fshehtës".

15. Nëse ty të thuhet: [Çfarë do të thotë islam?](#)

Thuaj: Islam është dorëzimi ndaj Allahut duke e njësuar Atë, nënshtrimi ndaj Tij duke iu bindur si dhe largimi prej shirkut.

Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(قَالَهُمْ إِلَهٌ وَاحِدٌ فَلَهُ أَسْلِمُوا وَبَشِّرِ الْمُخْبِتِينَ)

“Zoti juaj është një Zot i vetëm, prandaj vetëm Atij përuljuni.” (El Haxh 34)

Po ashtu, fjala e të Madhëruarit:

(يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنْتُمْ مُسْلِمُونَ)

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Al Imran 102)

16. Nëse ty të thuhet: [Cilat janë shtyllat e islamit?](#)

Thuaj: Shtyllat e islamit janë pesë. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Abdullah bin Umer (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((بني الإسلام على خمس: شهادة أن لا إله إلا الله وأن محمداً رسول الله، وإقام الصلاة، وإيتاء الزكاة، والحج، وصوم رمضان)).

“Feja islame ngrihet mbi pesë shtylla; Dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut e se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, kryerja e haxhit dhe agjërimi i muajit të ramazanit.”¹⁰

17. Nëse ty të thuhet: [Feja islame a është e plotë \(plotësuar\), apo ka nevojë për plotësim?](#)

Thuaj: Feja islame është fe e plotë (plotësuar). Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

((الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتْمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا))

“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjedha që Islami të jetë feja juaj.” (Maideh 3)

18. Nëse ty të thuhet: [Nga e merr muslimani fenë e tij?](#)

Thuaj: Muslimani e merr fenë e tij prej Kuranit dhe Sunetit sipas kuptimit e të parëve tanë të mirë (*selefus salih*). Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

((أَوَلَمْ يَكْفِهِمْ أَنَّا أَنْزَلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ يُتْلَىٰ عَلَيْهِمْ))

¹⁰ Mutefekun alejhi

“Vallë, a nuk u mjafton atyre që Ne të kemi shpallur ty Librin që u lexohet atyre?” (El Ankebut 51)

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(فَإِنْ تَنَازَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ)

“Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit.”

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ)

“Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!”

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(وَمَنْ يُشَاقِقِ الرَّسُولَ مِنْ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُ الْهُدَىٰ وَيَتَّبِعْ غَيْرَ سَبِيلِ الْمُؤْمِنِينَ نُوَلِّهِ مَا تَوَلَّىٰ وَنُصْلِهِ جَهَنَّمَ ۖ وَسَاءَتْ مَصِيرًا)

“Kushdo që e kundërshton të Dërguarin pasi i është dhënë udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur dhe do ta përcëllojmë në zjarrin e xhehenemit. Eh!, sa vendbanim i keq që është ai!” (En Nisa 115)

19. Nëse ty të thuhet: [Cila është akidja jote?](#)

Thuaj: Unë jam sunij selefi. Argument për këtë është hadithi ku Profeti (Paqja dhe bekimi I ALLahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((فعلیکم بسنتي وسنة الخلفاء المهديين الراشدين، تمسکوا بها وعضوا علیها بالنواجذ، وإیاکم ومحدثات الأمور؛ فإن کل محدثة بدعة، وکل بدعة ضلالة)).

“Ju këshilloj që të kapeni fort pas sunetit tim she sunetit të prijësve të drejt udhëzuar. Kapuni fort me dhëmballë dhe kini kujdes prej shpikjeve në fe, sepse çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është humbje.”¹¹

20. Nëse ty të thuhet: **Kush është i dërguari i parë i ardhur për njerëzimin si dhe kush është i Dërguari i fundit?**

Thuaj: I pari i tyre (të dërguarve) është Nuhu, ndërsa i fundit të tyre është Profeti më i mirë, Profeti ynë, Mmuhamedi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Ardhja e tij është prej shenjave të para të vogla të Kiametit. Prandaj, është detyrë për ne besimi në të gjithë të Dërguarit.

Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((فيأتون نوحا فيقولون: يا نوح أنت أول الرسل إلى أهل الأرض، وسماك الله عبدا شكورا)).

“Do të shkojnë tek Nuhu e do t’i thonë: O Nuh, ti je i pari i të Dërguarve për njerëzimin dhe Allahu të ka quajtur ty rob falënderues.”¹²

Ndërsa argumenti që tregon se Muhamedi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) është i fundit i të dërguarve është fjala e Allahut të Madhëruar:

(مَا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِّنْ رِّجَالِكُمْ وَلَكِن رَّسُولَ اللَّهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ)

“Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve” (El Ahzab 40)

Po ashtu edhe hadithi të cilin e transmeton Theubani (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

.((! ! !!!œ! !! !!!!!!! !! !!!!!))

¹¹ E ka nxjerr Ebu Daudi etj., Ky është *hadith hasen*.

¹² *Mutefekun alejhi*

“Unë jam vula e profetëve dhe nuk ka profet pas meje.”¹³

Ndërsa argumenti që tregon se ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) është më i miri i profetëve është hadithi, të cilin e transmeton Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((أنا سيد الناس يوم القيامة)).

“Unë do të jem zotëriu i njerëzve në Ditën e kiametit.”¹⁴

Kurse argumenti që na tregon se është detyrë për ne besimi në të gjithë të Dërguarit dhe se kush mohon ndonjë prej tyre, ai i ka mohuar të gjithë ata, është fjala e Allahut të Madhëruar:

(أَمَنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنْزِلَ إِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ وَالْمُؤْمِنُونَ كُلٌّ آمَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِنْ رُسُلِهِ)

“I Dërguari beson në atë (Kuranin) që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të Dërguarit e Tij (duke thënë): “Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij”. (El Bekare 285)

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(إِنَّ الَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ وَيُرِيدُونَ أَنْ يُفَرِّقُوا بَيْنَ اللَّهِ وَرُسُلِهِ وَيَقُولُونَ نُؤْمِنُ بِبَعْضٍ وَنَكْفُرُ بِبَعْضٍ وَيُرِيدُونَ أَنْ يَتَّخِذُوا بَيْنَ ذَلِكَ سَبِيلًا * أُولَٰئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ حَقًّا وَأَعْتَدْنَا لِلْكَافِرِينَ عَذَابًا مُهِينًا)

“Vërtet, ata që mohojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë Allahun nga të Dërguarit e Tij, duke thënë: “Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë” dhe duke dashur që kështu të zgjedhin një rrugë të ndërmjetme, pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur dënim poshtërues për mohuesit.” (En Nisa 150-151)

¹³ E ka nxjerr Muslimi

¹⁴ Mutefekun alejhi

Ndërsa argumenti që tregon se ai është prej shenjave të para të Kiametit është hadithi të cilin e transmeton Sehl bin Sad (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

!!!! !!!!! !!!!!!! !!!))

“Jam dërguar unë dhe Kiameti kështu” dhe bëri shenjë me gishtin e tij.¹⁵
Transmetohet nga Enes bin Malik (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((! !!!! !!!!! !!!!!!! !!!))

“Jam dërguar unë dhe kiameti si këta të dy.” Bashkoi gishtin tregues me atë të mesit¹⁶

21. Nëse ty të thuhet: **Në cilën gjë i ftuan njerëzit të gjithë të Dërguarit?**

Thuaj: I ftuan për në adhurimin ndaj Allahut Një e të vetëm, i Cili nuk ka shok.
Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ)

“Çdo populli Ne i çuam një të Dërguar (që u thoshte): “Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!” (En Nahl 36)

22. Nëse ty të thuhet: **Cili është teuhidi tek i cili ftuan të gjithë të dërguarit?**

Thuaj: Ai është të veçuarit e Allahut me adhurim.

Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَاعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا)

“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)...” (En Nisa 36)

¹⁵ Mutefekun alejhi

¹⁶ Mutefekun alejhi

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ * اللَّهُ الصَّمَدُ * لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ * وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ).

“Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!” (El Ihlas 1-4)

23. Nëse ty të thuhet: [Në sa pjesë ndahet teuhidi i Allahut të Lartësuar?](#)

Thuaj: Në tre pjesë:

1. Teuhidi er Rububijeh¹⁷ (Besimi në njësimin e Allahut si i vetmi Zot (Krijues, Sundues)

¹⁷ Pjesa e parë prej këtyre tre pjesëve është Teuhidi Rububije - Njësimi i Allahut në zotërim. Me të është për qëllim të pohosh me bindje të thellë dhe besim të plotë se vetëm Allahu i Madhëruar është Krijuesi, Furnizuesi, Mirëbërësi, Drejtuesi, Sistemuesi i të gjitha çështjeve të cilat kanë të bëjnë me krijesat e Tij. S'ka krijues tjetër përveç Tij. S'ka zot tjetër përveç Tij. S'ka kush që jep jetë dhe përcakton vdekje përveç Tij dhe askush përveç Allahut nuk komandon në gjithësi.

"Thuaj: “Kush është Zoti i qiejve e i tokës!” Thuaj: “Allahu!” {13, 16}.

I Madhëruari thotë:

"Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!" {1, 2}.

Po ashtu thotë:

"Ky është Allahu, Zoti juaj..." {35, 13}.

Ajetet që përbajnë këtë kuptim dhe që sqarojnë këtë lloj të Njësimin janë të shumta. Po ashtu, të gjitha ajetet në Kuran në të cilat përmendet krijimi, dhënia e jetës, përcaktimi i vdekjes, kontrolli mbi gjithësinë, bujaria, sistemimi (i çështjeve), gjykimi dhe përcaktimi etj; që të gjitha këto janë prej besimit në Teuhidin e zotërimit (rububije). Allahu i Madhëruar thotë:

"O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i Cili ju krijoi juve si dhe ata që ishin para jush ashtu që të jeni të devotshëm (të shpëtuar). Ai, i Cili për ju bëri tokën shtrat (vendbanim) e qiellin kulm, e prej qiellit ju lëshoi shi me të cilin ju siguroi lloje të frutave si ushqim për ju. Pra, mos i përshkruani Allahut shok, duke qenë se ju e dini (që Ai nuk ka shok). {2, 21 - 22}.

Krijoi, bëri, dhuroi, dha jetë, kontrolloi, që të gjitha këto janë shprehëse të njësimin në zotërim (rububije), si dhe të besuarit në të është prej besimit në Zotërimin e Allahut. Këtë lloj të Njësimin, politeistët (idhujtarët) e pranonin dhe nuk e refuzonin. Në lidhje me këtë, Allahu i Madhëruar thotë:

"Thuaj: “E kujt është toka dhe çdo gjë që ka në të, nëse jeni që e dini?” Ata do të thonë: “E Allahut”. Atëherë thuaju: “Përse pra nuk mendoni?” Thuaj: “Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zoti i Arshit të madh?” Ata do të thonë: “Allahu!”. Thuaju: “E pse nuk frikësoheni pra?” Thuaj: “Në dorën e kujt është i tërë pushteti i çdo sendi, dhe Ai është që mbron (atë që do), e që prej Atij nuk mund të ketë të mbrojtur; nëse jeni që e dini?” Ata do të thonë: “Në Dorë të Allahut!”

2. Teuhidi el Uluhiyeh¹⁸ (Besimi në njësimin e Allahut si i vetmi i Adhuruar, i Cili e meriton të adhurohet).
3. Teuhid El Esmāi ves Sifat¹⁹ (Besimi në njësimin e Allahut duke e veçuar Atë me emrat dhe cilësitë e Tij)²⁰

Thuaj: "E si mashtroheni pra?!" {23, 84 - 89}. [Shkëputur nga "Eksamu et Teuhid" e shejhu të nderuar Abdurrazak el Bedër] sh.p.

¹⁸ Ky lloj i teuhidit përbën edhe kuptimin e vërtetë të fjalës "La ilahe il laAllah – Nuk ka zot tjetër i cili meriton që të adhurohet me të drejtë përveç Allahut". Me Teuhidin Uluhiye është për qëllim veçimi i Allahut të Madhëruar me adhurim, përkushtimi i fesë vetëm Atij dhe refuzimi i idhujtarisë dhe idhujtarëve. Ashtu siç Allahu i Madhëruar thotë:

"E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, përveç se që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sigurtë ndaj Tij" {98, 5}.

Allahu i Madhëruar thotë:

"Medoemos se feja e vërtetë është vetëm për Allahun". {39, 3}.

"Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër përveç Tij. {17, 23}.

Gjithashtu i Lartësuar thotë:

"Ne dërguam në çdo popull të Dërguar që t'u thonë: "Adhuronit vetëm Allahun e largojuni djajve (adhurimit të tyre)!" {16, 36}.

"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë." {51, 56}.

Ajetet të cilat përmbajnë këtë kuptim janë të shumta.

Me *teuhidin uluhije* është për qëllim përkushtimi i fesë vetëm Allahut dhe veçimi i Tij me adhurim. Pra, të mos adhurojmë askënd tjetër përveç Allahut. Të mos i lutemi askujt tjetër përveç Allahut. Të mos i kërkojmë ndihmë askujt tjetër përveç Allahut. Të mos presim kurban për askënd tjetër përveç Allahut. Të mos kërkojmë mbështetje, përkrahje, ngadhënjim dhe shpëtim nga askush tjetër përveç Allahut. Ashtu siç Allahu është i Vetmi i Cili na ka krijuar, na furnizon dhe përkujdeset për ne, ashtu edhe ne duhet që vetëm Atë ta veçojmë me adhurim. I Madhëruari thotë:

"Unë jam Zoti juaj, pra, më adhuronit vetëm Mua." {21, 92}.

Pra, ashtu siç Ai është i Vetmi Zot, i pashoq në zotërimin e Tij, ashtu edhe ju vetëm Atë adhuronit. Ashtu siç Ai nuk ka ortak në krijim, furnizim, në dhënie e jetës, përcaktimin e vdekjes dhe sistemimin e çështjeve; ashtu edhe gjatë adhurimit nuk duhet t'i shoqërohet ortak. A është e logjikshme që Ai të krijojë e tjetërkush të adhurohet?! A është e logjikshme që Ai të furnizoi, ndërsa furnizimi të kërkohej prej dikujt tjetër?! Ai është i Cili shëron dhe mbron, ndërsa shërimi të kërkohej prej dikujt tjetër?! I Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në njërin prej lutjeve thotë:

"O Allahu im, Zoti i njerëzve! Largoje dhimbjen dhe më shëro, se Ti je Ai që shëron! S'ka shërim përveç se prej Teje!"

Ndërsa Ibrahim, miku i Allahut, prijësi i njësuesve tha:

"Dhe kur të sëmurem, Ai më shëron." {26, 80}.

Pra, me *teuhidin uluhije* është për qëllim veçimi i Allahut të Madhëruar me përlutje ndaj Tij, nënshtim, bindje, adhurim, namaz, haxh, lutje, kurban, betim; si dhe me të gjitha bindjet dhe adhurimet e tjera. Ndërsa "adhurimi" është term i përgjithshëm, i cili përfshin çdo gjë që Allahu do dhe është i kënaqur prej saj, qoftë ajo fjalë apo vepër; e dukshme apo e fshehtë. Adhurimi është e drejtë absolute e Allahut të Madhëruar. Ai i cili adhuronin ia përkushton dikujt tjetër përveç Tij, ai i ka shoqëruar shok (ortak) Allahut të Madhëruar.

[Shkëputur nga "Eksamu et Teuhid" e shejhu të nderuar Abdurrazak el Bedër]

Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ)

“Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!”

¹⁹ Me këtë është për qëllim që të besojmë me besim të paluhatshëm dhe të pohojmë me vendosmëri të plotë emrat dhe cilësitë. Emrat e bukur të Allahut të Madhëruar dhe cilësitë e madhërishme të Tij të cilat përmenden në Librin e Tij dhe në Sunetin e të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Ne të gjithë e kemi të qartë numrin e madh të emrave dhe cilësive të përmendura në Kuran dhe Sunet. Madje, thuajse nuk gjen ajet në Kuran i cili të mos përfundoj me ndonjë emër apo cilësi prej emrave dhe cilësive të Allahut të madhëruar. Allahu i madhëruar thotë:

"Allahu ka emrat më të mirë, andaj Atë thirrni me ata, e largohuni nga ata që bëjnë shtrembërime me emrat e Tij. Ata kanë për t'u shpërblyer (me dënim) për veprimet e tyre." {7, 180}.

Po ashtu, i madhëruari thotë:

"Ai është Allahu. Nuk ka zot, përveç Tij. Atij i takojnë emrat më të bukur." {20, 8}.

Po ashtu thotë:

"Thuaj: "Thërrisni: Allah ose thërrisni Er Rrahman. Me cilindo që ta thërrisni (me këta dy emra), emrat e Tij janë më të bukurit." {17, 110}.

Allahu thotë:

"Allahu është Ai, veç të Cilit s'ka të adhuruar tjetër të merituar, por vetëm Ai, i Gjithëdituri i të fshehtës dhe të dukshmes, Ai është Mëshiruesi, Mëshirëbërësi! Allahu është Ai, veç të Cilit s'ka të adhuruar tjetër të merituar, por vetëm Ai, Sunduesi, i Shenjti, Shpëtimtari, Siguruesi, Mbikëqyrësi, i Plotfuqishmi, Mbizotëruesi, i Madhërishmi. I Lartësuar është Allahu nga çka i shoqërojnë! Ai është Allahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi. Të tij janë emrat më të bukur. Atë (Allahun) e madhëron çka ka në qiej e në tokë dhe Ai është Ngadhënjyesi, i Urti! {59, 22-24}.

Në këtë kontekst të begatë, i cili përbën edhe fundin e sures El Hashër janë përmendur një pas një plotë shtatëmbëdhjetë emra prej emrave të Allahut të madhëruar. Po ashtu ,edhe ajeti Kursij, i cili është ajeti më madhështor në Kuran, përmban pesë nga emrat e Allahut të Madhëruar dhe më tepër se njëzetë cilësi prej cilësive të Tij. Për këtë arsye ky ajet është ajeti më madhështor në Kuran. Surja El Ihlas, vlere e së cilës është e barabartë me një të tretën e Kuranit, është quajtur surja El Ihlas (Sinqeriteti) pasi ajo i përkushtohet tërësisht cilësive të Mëshiruesit. [Shkëputur nga "Eksamu et Teuhid" e shejhu të nderuar Abdurrazak el Bedër]

²⁰ Ai i cili nuk beson në këto tre lloje të teuhidit, nuk është njësues, madje, ai nuk është as besimtar që beson në Allahun e madhëruar. Pasi besimi në Allahun nuk themelohet dhe nuk ngrihet ndryshe veçse mbi këto tre shtylla, të cilat ishin: Besimi në njësimin e Allahut si i vetmi Zot (Krijues, Sundues), në njësimin e emrave dhe cilësive të Tij, si dhe njësimin e Tij si i vetmi i Adhuruar. Madje, arsyeja për të cilën feja islame është quajtur ndryshe "Teuhid - Njësim", qëndron në faktin se ajo ngrihet mbi të besuarit në njësimin e Allahut si i vetmi Zotërues i vetmi i Adhuruar dhe i vetmi i Cili posedon emrat më të bukur dhe cilësitë më të larta. [Shkëputur nga "Eksamu et Teuhid" e shejhu të nderuar Abdurrazak el Bedër]

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(رَبُّ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا فَاعْبُدْهُ وَاصْطَبِرْ لِعِبَادَتِهِ هَلْ تَعْلَمُ لَهُ سَمِيًّا)

“Ai është Zoti i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që është midis tyre, prandaj vetëm Atë adhuroje dhe bëhu i qëndrueshëm në adhurimin ndaj Tij. A njeh ti ndokënd që ka Emrin e Tij?!” (Merjem 65)

Në këto dy ajete ndodhen të tria pjesët e teuhidit.

24. Nëse ty të thuhet: [Cila është e mira më e madhe dhe kush është e keqja më e madhe?](#)

Thuaj: E mira më e madhe është njësimi i Allahut të Lartësuar (teuhidi). Ndërsa e keqja më e madhe është shirku. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ)

“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Tij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë.” (En Nisa 48)

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(فَمَا لَنَا مِنْ شَافِعِينَ * وَلَا صَدِيقٍ حَمِيمٍ * فَلَوْ أَنَّ لَنَا كَرَّةً فَنَكُونُ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ)

“Tashmë ne nuk kemi asnjë ndërmjetësues (tek Allahu) e as ndonjë mik të ngushtë! Ah, sikur të ktheheshim përsëri (në jetë) e të bëheshim besimtarë!” (Esh Shuara 100-102)

Transmetohet nga Enes bin Malik (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((شفاعتي لأهل الكبائر من أمتي))

“Ndërmjetësimi im është për bërësit e mëkateve të mëdha nga populli im.”²¹

Po ashtu transmetohet nga Xhabir bin Abdullah (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((من مات لا يشرك بالله شيئا دخل الجنة، ومن مات يشرك بالله شيئا دخل النار)).

“Kush vdes dhe nuk i shoqëron Allahut asgjë, do të hyjë në xhenet. Ndërsa kush vdes dhe i shoqëron Allahut ndonjë gjë, ai ka për të hyrë në zjarr.”²²

25. Nëse ty të thuhet: [Sa janë gradat e fesë?](#)

Thuaj: Gradat e fesë janë tre:

1. Islami
2. Imani
3. Ihsani

Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Umer bin Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) në “Sahihun” e Muslimit me nr. 8 ku Xhibrili e pyeti të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në lidhje me islamin, pastaj për imanin dhe pastaj ihsanin.

26. Nëse ty të thuhet: [Çfarë është besimi?](#)

Thuaj: Besimi është shqiptimi me gojë, besimi me zemër dhe të punuarit me gjymtyrë. Ai shtohet me bindje, me vepra të mira, dhe pakësohet me punë të këqija.

Argumenti që tregon se besimi është të shqiptuarit me gojë dhe të punuarit me gjymtyrë është hadithi, të cilin e transmeton Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

²¹ E ka nxjerr Ahmed i dhe hadithi është i saktë.

²² E ka nxjerr Muslimi

((الإيمان بضع وسبعون أو بضع وستون شعبة، فأفضلها: قول: لا إله إلا الله، وأدناها: إمطة الأذى عن الطريق، والحياء شعبة من الإيمان)).

“Besimi është shtatëdhjetë apo gjashtëdhjetë e disa degë. Më e larta e tij është (dëshmia) se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, ndërsa më e ulëta e tij është largimi i pengesës nga rruga. Po ashtu, edhe turpi është degë e besimit.”²³

Ndërsa argumenti që tregon se ai besimi me zemër është hadithi i mësipërm që tregon për shtyllat e besimit, të cilin e transmeton Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) nga Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Po ashtu edhe fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَعَلَى اللَّهِ فَتَوَكَّلُوا إِن كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ)

“Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek Allahu!” (El Maide 23)

Transmetohet nga Enes bin Malik (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((آية الإيمان حب الأنصار، وآية النفاق بغض الأنصار)).

“Shenja e besimit është dashuria për ensarët, ndërsa shenja e nifakut (hipokrizisë) është urrejtja e ensarëve.”²⁴

Kurse argumenti që tregon se besimi shtohet me bindje e me vepra të mira, është fjala e Allahut të Madhëruar:

(إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَجِلَتْ قُلُوبُهُمْ وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ آيَاتُهُ زَادَتْهُمْ إِيمَانًا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ)

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten.” (El Enfal 2)

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

²³ Mutefekun alejhi

²⁴ Mutefekun alejhi

(هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ السَّكِينَةَ فِي قُلُوبِ الْمُؤْمِنِينَ لِيَزْدَادُوا إِيمَانًا مَعَ إِيمَانِهِمْ)

“Është Ai që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, për t’ua forcuar besimin, krahas besimit që patën.” (El Fet’h 4)

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(وَيَزِدَادَ الَّذِينَ آمَنُوا إِيمَانًا)

“E t’u shtohet besimi atyre që besojnë” (El Mudethir 31)

Ndërsa argumenti që tregon se ai pakësohet me vepra të këqija, janë po të njëjtat argumente që përmendem më sipër në lidhje me shtimin e besimit. Kjo ngase ai (besimi) para se të shtohet ka qenë i mangët.

Imam Buhari në “Kapitullin e Besimit” nga “Sahihun” e tij “tema 33” ka thënë: “Nëse lë diçka prej plotësimit, atëherë ai është e mangët”.

Po ashtu, prej argumenteve është edhe hadithi që përmendëm më sipër: **“Besimi është shtatëdhjetë apo gjashtëdhjetë e disa grada”**. Po ashtu, edhe hadithi të cilin e transmeton Seid bin Hudrij (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

!! !! !!! !!!!!!!!!!!!!! ! !! !!!!! !!!!!●!!!! !!!!! ! !! !!!!! !!!!!●!!!! !!!!! !!!!!!!!! !!!!! !!!!! !!!!! !!!!! !))

.((! !!! !

“Kush prej jush shikon ndonjë të keqe, atëherë le ta ndryshojë me dorën e tij. Nëse nuk mundet, atëherë le ta ndryshojë me gjuhën e tij. Por nëse përsëri nuk mundet, atëherë (ta ndryshojë) me zemrën e tij, por ky është besimi më i dobët.”²⁵

Në këtë hadith na bëhet e qartë se urrejtja e të ndaluarës është prej besimit.

27. Nëse ty të thuhet: **Sa shtylla ka besimi?**

²⁵ Muslimi në "Sahihun" e tij në "El Iman" 49, Et Tirmidhi në "El Fitneh" 2172, En Nesaiu 5009, Ebu Daudi në "Es Salah" 1140. Ibën Maxheh në "El Fitneh" 4013 dhe Ahmedi 3/10

Thuaj: Shtyllat e besimit janë gjashtë. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Umer bin Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) dhe ndodhet në “Sahihun” e Muslimit se Profetin (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e pyeti Xhibrili (alejhi selam) në lidhje me besimin, e ai tha:

‘((((!!! !!!!! ! !!! !!!!!!! !! !! ●! ! !!! !!!!! ●!! !! ●!!!! !! ●!!! !! !! ● !!!!! !! !!! !))’

“Të besosh në Allahun, engjëjt e Tij, librat e tij, të dërguarit e Tij, në ditën e Kiametit si dhe të besosh në paracaktimin qoftë për mirë ashtu edhe për keq.”

Xhibrili tha: "Të vërtetën ke thënë".

Ky hadith është *mutefekun alejhi*, i transmetuar prej Ebu Hurejrës (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

28. Nëse ty të thuhet: **Cili është përkufizimi për njohjen e ihsanit ndërmjet robit dhe Zotit të tij?**

Thuj: "Ihsan është të adhurosh Allahun, sikur ti je duke e parë Atë. Edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty."

Ashtu siç ka ardhur në hadithin të cilin e transmeton Umer bin Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) te Muslimi me nr. 8.

29. Nëse ty të thuhet: **Cili është gjykim për atë person që shan Allahun, të Dërguarit e Tij dhe fenë e Tij. Apo tallet me këtë?**

Thua: Ky është kufri i madh. Ai i cili e bën këtë duke qenë i vetëdijshëm, del prej popullit islam²⁶. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

²⁶ Nuk ka dallim në lidhje në gjykimin ndaj atij që shan profetin tonë, Muhamedin, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) apo sharjes së profetëve dhe të Dërguarve të tjerë, qoftë ai i Dërguar prej njerëzve apo prej engjëjve, apo i armiqësos që të gjithë ata apo ndonjërin prej tyre. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

“Allahu për zgjedh prej engjëjve të dërguar po ashtu edhe prej njerëzve.” (El Haxh 75)

Po ashtu fjala e Tij:

“Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej të dërguarve.” (El Bekare 285)

قُلْ أَلِلَّهِ وَأَيَّاتِهِ وَرَسُولِهِ كُنْتُمْ تَسْتَهْزِئُونَ * لَا تَعْتَذِرُوا قَدْ كَفَرْتُمْ بَعْدَ إِيمَانِكُمْ

“Nëse i pyet, ata do të të përgjigjen: “Ne vetëm po bënim shaka dhe po luanim”. Thuaj: “A mos vallë me Allahun, shpalljet dhe të Dërguarin e Tij po talleni?” Mos u shfajësoni! Ju e mohuat fenë, pasi patët besuar.” (Et Teube 65-66)

30. Nëse ty të thuhet: [Cili është shpërblimi për besimtarët dhe shpërblimi për jobesimtarët në ditën e Kiametit?](#)

Thuaj: Shpërblimi i besimtarëve është në xhenetin më të lartë. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(جَزَاؤُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتُ عَدْنٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ ذَلِكَ لِمَنْ خَشِيَ رَبَّهُ).

“Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira, pikërisht ata janë krijesat më të mira. Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet.” (El Bejjine 7-8)

Ndërsa shpërblimi i jobesimtarëve është zjarri, në gjendjen më të ultë e të ulëtave. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَالَّذِينَ كَفَرُوا لَهُمْ نَارُ جَهَنَّمَ لَا يُقْضَىٰ عَلَيْهِمْ فَيَمُوتُوا وَلَا يُخَفَّفُ عَنْهُمْ مِنْ عَذَابِهَا كَذَلِكَ نَجْزِي كُلَّ كَفُورٍ)

“Për jobesimtarët është përgatitur zjarri i xhehenemit, ku ata nuk do të vdesin dhe as që do t’u lehtësohet dënimi. Ja, kështu Ne do t’i dënojmë mosmirënjohësit.” (Fatir 36)

Argumenti që tregon se xheneti është në lartësitë me të lartë, është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَلَقَدْ رَآهُ نَزْلَةً أُخْرَىٰ * عِنْدَ سِدْرَةِ الْمُنْتَهَىٰ * عِنْدَهَا جَنَّةُ الْمَأْوَىٰ)

“Ndërkohë që ai e ka parë atë edhe një herë tjetër, te *Sidretul Munteha*-ja, ku ndodhet Xheneti i Strehimit.” (En Nexhm 13-15)

Argumenti që tregon se zjarri është në ultësirat më të ulëta është hadithi të cilin e transmeton El Bera (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë nga ajo çfarë i është transmetuar nga Zoti i tij i Lartësuar:

((اكتبوا كتاب عبي في سجين، في الأرض السفلى)).

“Ia shkruani librin rob-it tim në *Sixhin*, në thellësinë e tokës.”²⁷

Ne nuk dëshmojmë se personi është prej banorëve të xhenetit dhe se tjetri është prej banorëve të zjarrit, përveç për atë për të cilin ka dëshmuar argumenti, duke u bazuar në fjalën e Allahut të Madhëruar:

(وَلَا تَقْفُ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ)

“Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni.” (El Isra 36)

31. Nëse ty të thuhet: [Sa është numri i etapave në cilat kalon njeriu?](#)

Thuaj: Tre:

1. Jeta kalimtare në kësaj bote (*Ed Dunja el fena*).

Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا مَتَاعُ الْغُرُورِ)

“Ndërsa jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese.” (Al Imran 185)

2. Jeta e ndërmjetme (*Daru el Berzakh*)

²⁷ Hadith *hasen*

Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَمِنْ وَرَائِهِمْ بَرْزَخٌ إِلَى يَوْمِ يُبْعَثُونَ)

“Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse, deri në ditën kur do të ringjallen.” (Muminun 100)

3. Vendqëndrimi i përhershme (*Daru el Karar*)

Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar ku tregon në lidhje me besimtarin prej familjes së faraonit:

(يَا قَوْمِ إِنَّمَا هَذِهِ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا مَتَاعٌ وَإِنَّ الْآخِرَةَ هِيَ دَارُ الْقَرَارِ)

“O populli im, në të vërtetë, jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi e përkohshme, ndërsa jeta tjetër është Shtëpi e përhershme.” (Gafir 38)

32. Nëse ty të thuhet: **Cili është vendqëndrimi i parë i botës tjetër?**

Thuj: Vendqëndrimi i parë në botën tjetër është varri. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Uthman bin Affan (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

$\cdot((!!!!!! \quad !!!!! \quad !!!!! \quad !!!!!!! \quad !!!!! \quad !!\bullet!!!! \quad !!!!! \quad !!!!! \quad !!!!!!! \quad !!\bullet!! \quad ! \quad !!! \quad !!!!! \quad !!!! \quad !!!!! \quad !))$

“Varri është vendqëndrimi i parë i botës tjetër. Kush shpëton prej tij, edhe ajo që vjen më pas, është e lehtë. E nëse nuk shpëton prej tij, atëherë ajo që vjen më pas është më e vështirë.”²⁸

33. Nëse ty të thuhet: Çfarë beson ti në lidhje me dënimin dhe mirësinë e varrit?

²⁸ E ka nxjerr Et Tirmidhiu, Ibën Maxheh dhe Ahmedi dhe hadithi është *hasen*.

Thuaj: Unë besoj se ai është i vërtetë për çdo njeri. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Aisha (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) se ajo e ka pyetur të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në lidhje me dënimin e varrit, e ai tha:

.((! ! !! !!!!! ! ! !))

“Dënimi i varrit është i vërtetë.”²⁹

Po ashtu transmetohet prej saj se Profeti (Pajja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ishte që i kërkonte mbrojtje Allahut prej sprovës së varrit, dënimit të tij dhe sprova e mesihut Dexhal³⁰. Në këtë hadith na bëhet e qartë se dënimi i varrit është i vërtetë e po ashtu sprova e tij si dhe sprova e Dexhalit.

Prej argumenteve që tregojnë për mirësinë e tij është hadithi të cilin e transmeton El Berau (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ku në të thuhet:

.((!!!!!! !!!!!!!!! !! !!!!!!!!!!!!!!! !!! !!!!!!!!!!!!!!! !!!!!●!!! !!! !!!!! !!!!!!! !!!!!!! !!!!!!!!!))

“Ndërsa besimtarit do t’u thuhet: ‘I vishni atij prej petkave të xhenetit dhe hapeni atij një derë për në xhenet’ dhe i vjen atij aroma dhe flladi i tij (xhenetit)...”

34. Nëse ty të thuhet: Çfarë beson ti në lidhje me ringjalljen, llogarinë dhe marrjen e librit?

Thuj: Unë besoj se këto janë të vërteta dhe argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(زَعَمَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنْ لَنْ يُبْعَثُوا قُلْ بَلَىٰ وَرَبِّي لَتُبْعَثُنَّ ثُمَّ لَتُنَبَّيُنَّ بِمَا عَمِلْتُمْ وَذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ)

²⁹ *Mutefekun alejhi* dhe ky është teksti i Buhariut.

³⁰ *Mutefekun alejhi*

“Mohuesit kujtojnë se nuk do të ringjallen kursesi. Thuaju: “Po, për Zotin tim, me siguri që do të ringjallen e pastaj do të njoftoheni për atë ç’keni bërë!” Dhe kjo është e lehtë për Allahun.” (Et Tagabun)

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(فَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ بِيَمِينِهِ * فَسَوْفَ يُحَاسَبُ حِسَابًا يَسِيرًا * وَيَنْقَلِبُ إِلَى أَهْلِهِ مَسْرُورًا *
وَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ وَرَاءَ ظَهْرِهِ * فَسَوْفَ يَدْعُو ثُبُورًا * وَيَصْلَى سَعِيرًا)

“Atëherë ti, o njeri, që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjesh te Zoti yt. Ai, të cilit do t’i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë dhe do të kthehet i gëzuar te të afërmit e tij. Kurse ai, të cilit do t’i jepet libri i tij pas shpinës, do të lutet për të vdekur dhe në zjarr do të digjet.” (El Inshikak 6-12)

35. Nëse ty të thuhet: **A kanë për ta shikuar besimtarët Zotin e tyre ditën e Kiametit?**

Thuaj: Po, ata kanë për ta shikuar Atë në ndodhitë e Kiametit dhe në xhenet. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruarit:

(وَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ نَّاضِرَةٌ * إِلَىٰ رَبِّهَا نَاظِرَةٌ)

“Atë ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë dhe Zotin e tyre do të shohin.” (El Kijame 22-23)

Ndërsa në të dy “Sahihat” transmetohet prej Xherir bin Abdullah (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((إِنَّكُمْ سَتَرُونَ رَبَّكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ)).

“Ju keni për ta shikuar Zotin tuaj ditën e Kiametit.”

Po ashtu e ka nxjerr Muslimi prej rrugës së Hamad bin Selemeh nga Thabiti nga Abdurrahman bin Ebi Lejla nga Suhejbi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Në të vërtetë, Ne e kemi shpallur Kuranin në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju” (Ez Zuhruf 3)

Po ashtu fjala e Tij:

(نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْأَمِينُ * عَلَى قَلْبِكَ لِتَكُونَ مِنَ الْمُنْذِرِينَ * بِلِسَانٍ عَرَبِيٍّ مُبِينٍ).

“Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed) që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe.” (Esh Shuara 193-195)

38. Nëse ty të thuhet: [A ka Allahu emra dhe cilësi?](#)

Thuaj: Po, Ai ka emra dhe cilësi ashtu siç i takon Madhështisë së Tij. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَلِلَّهِ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ فَادْعُوهُ بِهَا)

“Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirreni Atë (lutjuni Atij) me to.” (El Araf 180)

Po ashtu fjala e Tij:

(وَلِلَّهِ الْمَثَلُ الْأَعْلَىٰ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ)

“Kurse, Allahut i përket shembulli më i lartë (cilësitë më të larta); Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.” (En Nahl 60)

Emrat e Allahut të Lartësuar nuk janë të kufizuara me ndonjë numër të caktuar për njohuritë tona. Argument për këtë është fjala e Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!):

((لَا أَحْصِي ثَنَاءَ عَلَيْكَ...))

“Unë nuk mund të arrij që të falënderoj dhe lavdëroj Ty ashtu siç i takon madhështisë Tënde.”

39. Nëse ty të thuhet: [A ka ndokush që e di të fshehtë të përveç Allahut?](#)

Thuaj: Askush nuk e di të fshehtë të përveç Allahut. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُظْلِعَكُمْ عَلَى الْغَيْبِ)

“Allahu nuk do t’ua zbulojë të fshehtë të (që vetëm Ai e di)” (Al Imran 179)

Po ashtu fjala e Tij:

(قُلْ إِنَّمَا الْغَيْبُ لِلَّهِ)

“Thuaj: “Me të vërtetë, të padukshmet i di vetëm Allahu.” (Junus 20)

Po ashtu fjala e Tij:

(وَعِنْدَهُ مَفَاتِيحُ الْغَيْبِ لَا يَعْلَمُهَا إِلَّا هُوَ)

“Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ato.” (El Enam 59)

40. Nëse ty të thuhet: [Kur do të ndodhë Kiameti?](#)

Thuaj: Çështja e Kiametit është prej çështjeve të fshehta, të cilat nuk i di vetëm se Allahu i Madhëruar.

Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(إِنَّ اللَّهَ عِنْدَهُ عِلْمُ السَّاعَةِ).

“Pa dyshim, vetëm Allahu e di Orën e caktuar.” (Lukman 34)

Po ashtu fjala e Tij:

(إِلَيْهِ يُرَدُّ عِلْمُ السَّاعَةِ)

“Vetëm Allahu e di se kur do të vijë Ora.” (Fussilet 47)

Po ashtu dhe fjala e Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

..(((! !!! !!! !! !!!!!!! !!!!!!!)))

“Nuk e di askush se kur do të ndodhë Kiameti vetëm se Allahut.”³¹

41. Nëse ty të thuhet: [Sa kushte janë për pranimin e veprës?](#)

Thuaj: Ato (kushtet) janë tre:

1. Islami, ndërsa, në lidhje me jobesimtarin, Allahu nuk e pranon punën e tij. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَقَدِمْنَا إِلَى مَا عَمِلُوا مِنْ عَمَلٍ فَجَعَلْنَاهُ هَبَاءً مَنْثُورًا)

“Dhe Ne do t’u qasemi veprave që kanë bërë ata dhe do t’i shndërrojmë në pluhur e hi.” (El Furkan 23)

2. Sinqeriteti

Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ)

“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë” (El Bejjine 5)

Ndërsa në hadithin *kudsi* të cilin e transmeton Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

³¹ E ka nxjerr Buhariu prej hadithit të Ibën Umerit (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!).

!!!! !!!!! ! !!! !!!!!!!!!!! !! !!! !!!!! !!!!! !!!!! ! ! !!!!! !!!!! ! !!!!! ! !!!!!!! !!!!! ! !!!!! !!!!! !!!!!))
 .((!!!!

“Allahu i madhëruar ka thënë: Unë jam më i panevojshëm nga të pasurit shokë. Kush vepron diçka duke më shoqëron në të shok, atëherë unë e lë atë dhe atë që ai më shoqëron Mua.”³²

3. Pasimi i të dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Argument për këtë është hadithi, të cilin e transmeton Aisha (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

مَنْ عَمِلَ عَمَلًا لَيْسَ عَلَيْهِ أَمْرُنَا فَهُوَ رَدٌّ

"Kushdo që punon një vepër e cila nuk është sipas çështjes sonë, ajo është e refuzuar."³³

42. Nëse ty të thuhet: **Sa janë llojet e tevesulit të ligjëruar?**

Thuaaj: Llojet e *tevesulit* janë tre:

1. *Tevesuli* me anë të emrave të Allahut dhe cilësive të Tij. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَلِلّٰهِ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ فَادْعُوهُ بِهَا)

“Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirrreni Atë (lutjuni Atij) me to” (El Earaf 180)

Po ashtu fjala e Tij:

(وَأَدْخِلْنِي بِرَحْمَتِكَ فِي عِبَادِكَ الصَّالِحِينَ)

“Më prano me mëshirën Tënde në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!” (En Neml 19)

³² E ka nxjerr Muslimi

³³ E ka nxjerr Muslimi

2. *Tevesuli* i rob-it tek Allahu i Madhëruar me ana të punës së tij të mirë. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(الَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا إِنَّنَا آمَنَّا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ)

“Ata të cilët thonë: “Zoti ynë! Me të vërtetë kemi besuar, andaj na i fal gjynahet tona dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit!” (Al Imran 16)

Po ashtu fjala e Tij:

(رَبَّنَا آمَنَّا بِمَا أَنْزَلْتَ وَاتَّبَعْنَا الرَّسُولَ فَاكْتُبْنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ)

“Zoti ynë! Ne besojmë atë që na ke shpallur dhe pasojmë të Dërguarin (Isain). Na shkruaj, pra, bashkë me dëshmitarët!” (Al Imran 53)

Ndërsa argument prej Sunetit është hadithi i tre personave, të cilët ishin në shpellë dhe guri ia zuri hyrjen e shpellës. Ndërsa secili prej tyre iu drejtuar Allahut me punët më të mirë dhe më të singertë që kishin bërë. *Mutefekun alejhi*.

3. *Tevesuli* me anë të lutjes së personit vepër mirë.

Argument për këtë është hadithi i Enes bin Malik (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë:

“Ndërsa i dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ishte duke ligjëruar, kur ja, erdhi atij dhe person dhe i tha: ‘O i Dërguari i Allahut, thatësi e madhe! Prandaj lute Allahun që të na sjellë shi. Dhe ai e luti Allahun dhe ra shi’.

43. Nëse ty të thuhet: [A ka në fe bidat të mirë?](#)

Thuaj: Çdo bidat është humbje dhe argument për këtë është hadithit:

((كُلُّ بَدْعَةٍ ضَلَالَةٌ)).

“Çdo bidat është humbje.”

Po ashtu edhe hadithi të cilin e transmeton Xhabir bin Abdullah (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) kur mbante ligjëratë thoshte:

!!!! !!!!! ! !•! !!!!! !!!!! !!!!! !!!!! !!!!! ! !•! ! ! ! ! ! ! ! ! ! !•! !!! !!! ! ! ! ! ! ! !!!!! !!!!!))
 .((!!! !

“E më pas, me të vërtetë thënia më e mirë është Libri i Allahut, ndërsa udhëzimi më i mirë ëhstë udhëzimi i Muhamedit. Punët me të këqija janë shpikjet në to, ndërsa çdo bidat është humbje.”³⁴

44. Nëse ty të thuhet: **Kush janë krijesat më të këqija, të cilët ne e kemi detyrë t'i urrejmë?**

Thuj: Krijesat më të këqija janë çifutët, të krishterët dhe mushrikët. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ وَالْمُشْرِكِينَ فِي نَارِ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا أُولَئِكَ هُمْ شَرُّ الْبَرِيَّةِ)

“Në të vërtetë, ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, do të hyjnë në zjarrin e Xhehenemit, në të cilin do të mbeten përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija.” (El Bejjine 6)

Po ashtu fjala e Tij:

(لَا تَجِدُ قَوْمًا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ يُوَادُّونَ مَنْ حَادَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ)

“Nuk gjen njerëz që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit që të ushqejnë dashuri ndaj atyre të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij” (El Muxhadile 22)

³⁴ E ka nxjerr Muslimi

45. Nëse ty të thuhet: [Çfarë është demokracia?](#)

Thuaj: Ajo është gjykimi popullit nga mendja e tij, duke mos e marrë gjykimin nga Kurani dhe as nga Suneti.

46. Nëse ty të thuhet: [Cili është gjykimi për të \(demokracinë\)?](#)

Thuaj: Ajo është shirku i madh. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(إِنَّ الْحُكْمَ إِلَّا لِلَّهِ)

“Vendimi i përket vetëm Allahut” (Jusuf 40)

Po ashtu fjala e Tij:

(وَلَا يُشْرِكُ فِي حُكْمِهِ أَحَدًا)

“Dhe mos i shoqëro asgjë në gjykimin e Tij.”

47. Nëse ty të thuhet: [Cili është realiteti i votimeve?](#)

Thuaj: Ato janë prej sistemit të demokracisë, i cili është në opoenencë (kontradikte, kundërshtim) me ligjin e Allahut. E kjo është përngjasim me jobesimtarët, kurse përngjasimi me ta nuk lejohet. Ngase në të ka dëm shumë të madh dhe nuk ka aspak dobi për muslimanët. Prej dëmeve më të mëdha është barazimi i të vërtetës me të kotën, humbja e miqësimin dhe urrejtjes, shpërbërjen (copëtimin) e bashkësisë së muslimane, hedhja ndërmjet tyre e armiqësisë, urrejtjes, partishmërisë, mashtrimit, shpifjeve, humbjes së kohës dhe pasurisë, përdhosjen e nderit të grave si dhe zhdukjen e besimit në dijet e sheriatit islam dhe dijetarëve të saj.

48. Nëse ty të thuhet: [Cili është gjykimi në lidhje me ndarjen në grupacione?](#)

Thuaj: Ajo është haram (e ndaluar), përveç partisë (palës) së Allahut. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَلَا تَكُونُوا مِنَ الْمُشْرِكِينَ * مِنَ الَّذِينَ فَرَّقُوا دِينَهُمْ وَكَانُوا شِيعًا كُلُّ حِزْبٍ بِمَا لَدَيْهِمْ
فَرِحُونَ)

“Drejtojuni Atij me pendesë, frikësojuni Atij dhe falni namazin e mos u bëni si ata, që i shoqërojnë Atij diçka tjetër (në adhurim), si ata që fenë e vet e kanë përçarë dhe janë ndarë në grupe, e ku çdo grup është i kënaqur me atë që ka.” (Er Rum 31-32)

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(وَأَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا)

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!” (Al Imran 103)

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(إِنَّ هَذِهِ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَأَنَا رَبُّكُمْ فَاعْبُدُونِ)

“Vërtet, ky është besimi juaj - besimi i vetëm, e Unë jam Zoti juaj, andaj më adhuroni Mua!” (El Enbija 92)

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(أَلَا إِنَّ حِزْبَ اللَّهِ هُمُ الْمُفْلِحُونَ)

“Vërtet që Pala e Allahut do të jetë fituese.” (El Muxhadile 22)

Transmetohet nga Abdullah bin Amër el Asi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((وتفترق أمتي على ثلاث وسبعين ملة كلهم في النار إلا ملة (أي فرقة) واحدة)).
قالوا: ومن هي يا رسول الله؟ قال: ((ما أنا عليه وأصحابي)).

“Populli im do të ndahet në 73 grupe. Të gjitha do të jenë në zjarr, përveç njërës.” Thanë: ‘Kush është ajo, o i Dërguari i Allahut?’ Tha: “Janë atë që ndodhen në atë që jam unë sot dhe shokët e mi.”³⁵

Fjala e tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!): ‘Të gjitha do të jenë në zjarr’, është një qortim i ashpër kundër pasuesve të epshit dhe na bën me dije gjendjen e tyre.

49. Nëse ty të thuhet: [Cilat janë grupacionet më të humbura të cilat ftojnë në islam?](#)

Thuaj: Ata janë batinijet, rafidat, xhehmijet dhe sufisët ekstremist.

Parime të jurisprudencës islame (fikhut):

50. Çdo adhurim duhet patjetër që të jetë i shoqëruar me nijetin. Vendi i nijetit është zemra. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Umer bin Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((!!!!!!! !!! !!!!!))

“Me të vërtetë që veprat vlerësohen sipas qëllimit”³⁶

51. Shqiptimi i nijetit me gojë është bidat. Argument për këtë është hadithi i Aishes (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((!!!!!!!!!!!! !!!!!!! !!!!!!! !! !! !!! !))

“Kushdo që shpik diçka në këtë çështjen tonë (në fe), që nuk është prej saj, ajo është e refuzuar.”³⁷

³⁵ E ka nxjerr Et Tirmidhiu 5/26, po ashtu ky hadith ka dhe dëshmuar prej hadithit të Muavijes (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), e ka nxjerr Ebu Daudi me nr. 4597 dhe Ahmedi 4/102. Po ashtu ky ka edhe dëshmuar të tjerë. Hadithi është *hasen*.

³⁶ *Mutefekun alejhi*

52. Nëse ty të thuhet: Çfarë është bidati?

Thuaj: Bidat është ajo gjë që është shpikur pas vdekjes së Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), me qëllim adhurimi për të cilën nuk ka argument nga Kurani dhe as nga Suneti.

53. Allahu e ka krijuar ujin të pastër për t'u pastruar nga papastërtitë si dhe kur kryejmë nevojën. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَأَنْزَلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً طَهُورًا)

“Dhe kemi lëshuar prej qiellit ujë të pastër” (El Furkan 48)

Po ashtu fjala e të Madhëruarit:

(وَيُنَزِّلُ عَلَيْكُمْ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً لِيُطَهِّرَكُمْ بِهِ)

“Dhe lëshoi nga qielli shi, për t'ju pastruar nëpërmjet atij” (El Enfal)

54. Çfarë thotë personi, kur futet në WC?

Transmetohet nga Enes bin Malik (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: Ishte Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) që kur futej në WC thoshte:

.(((! !!!! !!! !! !!! !!! !!!!!!!! !!!!!!!!)))

55. Edukata e kryerjes së nevojës. Transmetohet nga Selman el Farisiu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se atij i është thënë: “Profeti juaj ju ka treguar çdo gjë, madje edhe edukatën e shkuarjes në WC?” Tha: “Po, ashtu është. Dhe na ka ndaluar që të kthehemi

³⁷ E transmeston Buhariu në "Sahihun" e tij 2697 Muslimi në "Sahihun" e tij (17) 1718 dhe teksti është i tij. Ebu Daudi 4606, Ibën Maxheh 14, Ahmedi 6/73, 146, 180, 240, "El Iruau" 88, "Sahihu Gajetul Meram" 5 dhe "Sahihul Xhami" 5970

në drejtim të kibles gjatë kryerjes së nevojës dhe urinës apo që të mos pastrohemi me dorën e djathtë si dhe mos të pastrohemi më pak se tre gurë”. E ka nxjerr Muslimi.

56. Namazi nuk është i saktë vetëm se duke qenë me abdes. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((!! !!!!! ! !! ! !!!!! ! !! !!!!!))

“Allahu nuk e pranon namazin (e askujt) pas kryerjes së nevojës veçse pasi ai të marrë abdes.”³⁸

Po ashtu transmetohet nga Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

.((!!!!!! !!!!! ! !! !!!!!))

“Allahu nuk e pranon namazin pa qenë i pastër (abdes).”³⁹

57. Pjesët të cilat lahen gjatë marrjes së abdesit: Fytyra, futja e ujit në gojë dhe në hundë, larja e duarve deri te bërrylat, dhënia mes’h kokës si dhe larja e këmbëve deri tek njejt. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ)

“O besimtarë! Kur doni të falni namaz, lani fytyrën dhe duart deri në bërryla, kurse kokën fshijeni me dorë të lagët; lani edhe këmbët deri në njejt.” (Maide 6)

Po ashtu edhe hadithi të cilin e transmeton Abdullah bin Amër (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

³⁸ Mutefekuna alejhi

³⁹ E ka nxjerr Muslimi

(!!!!!!! !!! !!! !!))

"Mjerë për thembrat e këmbëve nga zjarri (i xhehenemit)!"⁴⁰

58. Dhënia përparësi së djathtës gjatë marrjes së abdesit, larja e fytyrës deri te flokët dhe e krahëve deri në muskuj (mbi bërryla). Argument për këtë është hadithi i Ebu Hurejrës (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) lau krahun e djathtë dhe filloi me larjen e llërës (pjesën e sipërme të krahut nga bërryli deri te supi), lau dorën e majtë dhe filloi me larjen e llërës, pastaj i dha mes'h kokës, pastaj lau këmbën e tij të djathta deri te nyja e saj, pastaj lahu këmbën e majtë po ashtu deri te nyja dhe tha:

"Ju do të dalloheni nga gjurmët e abdesit Ditën e Kiametit.." ⁴¹

Po ashtu saktësohet te "Sunenu Ebi Daud" prej hadithit të cilin e transmeton Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((إِذَا لَبَسْتُمْ، وَإِذَا تَوَضَّأْتُمْ، فَابْدِءُوا بِأَيْمَانِكُمْ))

"Kur të visheni dhe kur të merrni abdes, filloni me anën e djathtë."

59. Forma më e mirë që tregon sesi ka marrë abdes i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!):

"Ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) lahu duart e tij tre herë, pastaj futi ujë në gojë dhe në hundë (bashkon ndërmjet futjes së ujit në gojë dhe hundë me një grusht të vetëm , tre herë), pastaj lahu fytyrën e tij tre herë, pastaj lau duart e tij deri te bërrylat, pastaj i dha mes'h kokës një herë të vetme me ujë tjetër dhe jo e atë që mbeti, duke filluar me pjesën e përparme të kokës deri te damarët, pastaj kthehet aty ku filloi. Pastaj lau këmbë e tij tre herë deri te nyejt".

⁴⁰ E ka nxjerë Buhbairu 163 dhe 165, Muslimi 241, 242 dhe 240, Ahmedi 9/24570 dhe En Nesai 1/77-78.

⁴¹ Muslimi

Kjo formë e abdesit saktësohet nga hadithi të cilin e transmeton Uthmani⁴² (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) dhe që është *mutefekun alejhi*. Po ashtu në të ka edhe shtesa të tjera që kanë ardhur në hadithe të tjera të sakta.

Gjithashtu, është e pëlqyeshme përdorimi i misvakut para fillimit të namazit. Argument për këtë është hadithi i Ebu Hurejrës (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((لَوْ لَا أَنِ أَشَقَّ عَلَى أُمَّتِي لِأَمْرَتِهِمْ بِالسَّوَاكِ عِنْدَ كُلِّ صَلَاةٍ)).

"Sikur të mos e rëndoja popullin tim, do t'i urdhëroja ata të përdornin misvak (për pastrimin e dhëmbëve) në çdo namaz (para fillimit të çdo namazi)."⁴³

60. Kush vesh meste apo çorape duke qenë me abdes, i lejohet atij që t'u japë mes'h nga sipër atyre. Nëse personi është vendas, u jep mes'h atyre një ditë-natë, ndërsa, nëse është udhëtar, u jep mes'h atyre tre ditë-natë. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Ebu Bekrah (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka lejuar për udhëtarin që kur merr abdes dhe vesh *hufet* e më vonë e prish abdesin që t'u japë mes'h atyre tre ditë-natë, kurse për vendasin një ditë-natë. E ka nxjerr Ibën Maxheh dhe hadithi është *hasen*.

U jepet mes'h vetëm në pjesën e sipërme. Argument është hadithi i Ali bin Ebi Talib (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: e kam parë të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) që t'u japë mes'h nga sipër *hufeve* të tij. E ka nxjerr Ebu Daudi dhe është *sahih*.

⁴² Transmetohet nga Humran (shërbëtori i Uthman bin Afan) se:

"Ai pa Uthmanin të kërkonte ujë për abdes dhe pastaj hodhi ujë nga ena në dy duart e tij dhe i lau ato tri herë. Pastaj futi dorën e djathtë në enë (dhe mori ujë), futi ujë në gojë e në hundë, pastaj lau fytyrën tri herë dhe krahët deri në bërryla, tri herë. Pastaj i dha mes'h (e preku me dorë të lagur) kokës së tij dhe lau këmbët nga tri herë, pastaj tha: 'Kështu e kam parë të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) të marrë abdes si mora unë, dhe pastaj tha: "**Kush merr abdes kështu siç mora unë, pastaj fal dy rekate në të cilat nuk flet me vete (por përqendrohet në namaz), atij i falen të gjitha gjynahet që ka bërë më parë.**" E transmeton Buhariu 164, 159, 160, 1934, 6433, Muslimi 226, Ebu Daudi 106- 107, 110, Nesai 1/64-65.

⁴³ E transmeton Buhariu 887, Muslimi 252, Ahmedi, etj.

61. Nëse vjen koha e namazit dhe nuk gjen ujë, atëherë merr tejemum. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا فَامْسَحُوا بِوُجُوْهِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ مِنْهُ)

“E nëse nuk gjeni ujë, atëherë gjeni dhé të pastër dhe fshini fytyrat e duart me të.”
(Maide 6)

"Saiden" tek ajeti është për qëllim dheu i tokës.

Po ashtu argument është edhe hadithi i Hudhejjes se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

.((!!!!! !!!!! !!!!!!! !!!!!!! !!!!!!! !!!!!!! !!! !!●!! ! !!!!!!! ! !!!!!!! !!! !))

“Neve e gjithë toka na është bërë vend-falje, kurse dheu i saj na është bërë si pastrim, nëse nuk gjejmë ujë.”⁴⁴

62. Kur të mbarosh nga marrja e abdesit thuaj:

أشهد أن لا إله إلا الله، وأن محمدا عبده ورسوله

“Dëshmoj se nuk ka zot tjetër që meriton që të adhurohet me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i tij.”

Argument është hadithi të cilin e transmeton Umer bin Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((ما منكم من أحد يتوضأ، فيسبغ الوضوء، ثم يقول أشهد أن لا إله إلا الله وأن محمدا عبده ورسوله إلا فتحت له أبواب الجنة الثمانية يدخل من أيها شاء)).

“Nëse ndonjëri prej jush merr abdes në formën më të mirë e pastaj (në përfundim të tij) thotë: ‘Dëshmoj se nuk ka zot tjetër që meriton që të adhurohet me të drejtë përveç

⁴⁴ Muslimi

Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i tij', vetëm se i hapen atij të tetë dyer e xhenetit dhe futet në prej nga cila derë që të dëshirojë."⁴⁵

63. Gjërat që e prishin abdesin janë:

1. Çdo gjë që del prej dy rrugëve të jashtëqitjes. Argument për këtë është hadithit të cilin e transmeton Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!):

((لا تقبل صلاة من أحدث حتى يتوضأ))

"Allahu nuk e pranon namazin (e askujt) pas kryerjes së nevojës veçse pasi ai të marrë abdes."⁴⁶

2 & 3. Gjumi i thellë dhe xhunubllëku (dalja e spermës, qoftë me anë të kryerjes së marrëdhënieve intime apo kur sheh diçka në ëndërr). Argument për këtë është hadithi Safvan bin Asal (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë:

"I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) na urdhëronte kur ishim në udhëtim që mos t'i hiqnim mestet për tre ditë-natë, përveç në rast kur ishim xhunub".

E ka nxjerr Et Tirmidhiu dhe hadithi është *hasen*. Ndërsa gjumi i profetëve nuk ia prish abdesin atyre, kjo duke u bazuar në hadithin të cilin e transmeton Enes bin Malik (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

الأنبياء تنام أعينهم ولا تنام قلوبهم

"Profetëve u flenë sytë, por edhe jo zemrat e tyre."⁴⁷

Dhe kjo gjë është e veçantë vetëm për ata (alejhis salatu ves selam).

4. Prekja e organit intim.

⁴⁵ Muslimi

⁴⁶ Mutefekuna alejhi

⁴⁷ Buhariu

Argument për këtë është hadithi i transmetuar nga Bintu Safvan (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((من مس ذكره فلا يصل حتى يتوضأ)).

“Kush prek organin e tij, atëherë të mos falet derisa të marrë abdes.”⁴⁸

5. Ngrënia e mishit të deveës.

Argument për këtë është hadithi, të cilin e transmeton Xhabir bin Semura (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se një person e pyeti të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!): “A të marrim abdes nga ngrënia e mishit të deveës?” Tha: “Po!”⁴⁹

6. Të dalët prej fesë islame.

Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(وَمَنْ يَخْفُرْ بِالْإِيمَانِ فَقَدْ حَبِطَ عَمَلُهُ)

“Kushdo që mohon besimin, veprat e tij do të zhvlerësohen” (Maide 5)

7. Ikja e mendjes me anë të çmendurisë apo kur dehesh apo kur të bie të fikët. Si dhe me gjëra të ngjashme si këto prej ilaçeve që bëhen shkak për ikjen e mendjes. Dijetarët kanë rënë dakord se abdesi priset ma anë të këtyre gjërave.

64. Është detyrë për muslimanin që të falë në ditë-natë pesë namaze të obliguara. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Talha bin Ubejdullah (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se një person e pyeti të Dërguarin i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) për islamin. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha:

((خمس صلوات في اليوم والليلة)).

“Janë pesë namaze në ditë-natë.”⁵⁰

⁴⁸ Et Tirmidhiu dhe hadithi është *hasen*

⁴⁹ Muslimi

⁵⁰ Mutefekun alejhi

65. Për çdo kohë (të namazit) ezani thirret në kohën e përcaktuar për faljen e namazit. Argument për këtë është hadithi i Malik bin el Huvejrith (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Kur të hyjë koha e namazit, le ta thërrasë ezanin ndonjëri prej jush dhe pastaj të dalë imam ai i cili është më i madhi nga ju.”⁵¹

66. Kush e dëgjon muezini, atëherë le të thotë ashtu siç thotë edhe ai. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Ebu Seid el Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Kur të dëgjoni ezanin, atëherë thoni ashtu siç thotë muezin.”⁵²

67. Nëse thirret ikameti për fillim e namazit, atëherë drejtohu për nga kibla (Qabja). Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(قَالُوا يٰٓاَيُّهَا قَبِيْلَةُ ثَرْصَاهَا فَوَلَّ وَجْهَكَ شَطْرَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ وَحَيْثُ مَا كُنْتُمْ فَوَلُّوا وُجُوْهُكُمْ
شَطْرَهُ)

“Ne të pamë ty (Muhamed) që vazhdimisht drejtoje shikimin nga qielli. Mirë pra, Ne do të të kthejmë ty nga kibla që të kënaq ty. Prandaj, ktheje fytyrën tënde nga xhamia e shenjtë (Qabeja)! Dhe kudo që të gjendeni, kthejeni fytyrën tuaj nga ajo anë!” (El Bekare 144)

⁵¹ *Mutefekun alejhi*

⁵² *Mutefekun alejhi*

68. Duart në namaz ngrihen në katër vende. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Abdullah bin Umer (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), kur fillonte namazin, merrte tekbir dhe i ngrinte duart e tij deri tek veshët, pastaj, kur binte në ruku, përsëri i ngrinte duart. E kur thoshte: “*SemiAllahu limen hamideh*”, i ngrinte duart. Edhe kur ngrihej prej rukusë, i ngrinte duart e tij.” E ishte Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!) që vepronte në këtë mënyrë.⁵³

69. Duaja më e saktë për hapjen e namazi pas tekbirit fillestar është ajo çfarë transmetohet nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: “I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), ndërmjet tekbirit (fillestar) dhe leximit (të Fatihasë) qëndronte pak në heshtje. I thashë: ‘O i Dërguari i Allahut, flijim për ty qofshin nëna dhe babai im, çfarë thua gjatë pushimit tënd ndërmjet tekbirit dhe leximit? Tha:

((م باعد بيني وبين خطاياي كما باعدت بين المشرق والمغرب، اللهم نقني من الخطايا كما ينقى الثوب الأبيض من الدنس، اللهم اغسل خطاياي بالماء والثلج والبرد)). أقول
الله

Them: O Zoti im, më largo mua nga mëkatet e mia ashtu siç ke larguar lindjen nga perëndimi. O Zoti im, më pastro mua prej mëkateve ashtu siç pastron rrobat e bardha nga njollat. O Zoti im, më pastro mua prej mëkateve me ujë, borë dhe akull.⁵⁴

70. Para se të fillosh me lexim e sures El Fatiha, kërkoji mbrojtje Allahut prej shejtanit të mallkuar si dhe përmend emrin e Tij, porse në heshtje. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar:

(فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ)

“Kur dëshiron të lexosh Kuranin, kërko mbrojtjen e Allahut kundër djallit të mallkuar” (En Nahl 98)

⁵³ Mutefekun alejhi

⁵⁴ Buhariu me nr [744] dhe Muslimi me nr [597].

Po ashtu edhe hadithi të cilin e transmeton Enes bin Malik (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), Ebu Bekri dhe Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!) e fillonin namazin e tyre me:

(الحمد لله رب العالمين).

“Falënderimet i takojnë vetëm Allahut, Zotit të botëve.”

Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet: “Nuk e shqiptonin me zë “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!”⁵⁵

71. Pas kërimit mbrojtje nga Allahu prej shejtanit si dhe pas thënies së “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!” fillo nga leximi i sures El Fatiha. Argument për këtë është fjala e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!):

((! !!! !!!!! !!!!! !!!!! !!!!! ! ! !))

“Nuk ka namaz për atë person i cili nuk lexon suren Fatiha.”⁵⁶

72. Falja e namazit bëhet me qetësi. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) i tha personit që nxitoi në faljen e namazit të tij:

((إذا قمت إلى الصلاة فكبّر، ثم اقرأ ما تيسر معك من القرآن، ثم اركع حتى تطمئن راکعاً، ثم ارفع حتى تعتدل قائماً، ثم اسجد حتى تطمئن ساجداً، ثم افعل ذلك في صلاتك كلها)).

“Kur të ngrihesh për të falur namazin, merr tekbir e pastaj lexo çfarë të lehtësohet prej Kuranit. Pastaj bjer në ruku dhe qëndro ashtu, derisa të qetësohesh, pastaj ngrihu prej saj dhe qëndro drejt e pastaj bjer në sexhde dhe rri në atë pozicion, derisa të qetësohesh.

Kështu vepro në të gjitha namazet e tua.”⁵⁷

⁵⁵ Ahmedi 3/179 dhe En Nesaiu 2/135 me *sened* të saktë.

⁵⁶ *Mutefekun alejhi*

⁵⁷ *Mutefekun alejhi*

73. Kur shkohet për në sexhde, vendos duart në fillim. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton El Berau bin Azab (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë:

“Kur i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) thoshte: *“SemiAllahu limen hamideh”*, askush nuk e përkulte shpinën, derisa të binte i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në sexhde e pas tij binim në sexhde.”⁵⁸

Përkulja e shpinës bëhet kur ulesh (zbret) me duar.

74. Dhikri në ruku dhe në sexhde. Transmetohet nga Hudhejfe (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Pajja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) kur shkante në ruku thoshte:

((سبحان ربي العظيم))،

“I Lartësuar dhe pa të meta është Zoti im i Madhëruar.”

Ndërsa në sexhde ai thoshte:

.((! !! ! !!! ! !! !!))

*"I pa të meta është Zoti im, i Lartësuar."*⁵⁹

75. *Tesh'heudi* në namaz. Forma më e saktë e *tesh'heudit* është ajo të cilën e transmeton Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Kur ndonjëri prej jush të jetë në *tesh’ehud*, atëherë le të thotë:

[illegible]

⁵⁸ *Mutefekun alejhi*

⁵⁹ E ka nxjerr Muslimi me nr. 772

"Lavdërimet më të mira janë vetëm për Allahun. Urimet më të mira qofshin mbi ty, o Profet (i Allahut), mëshira dhe lavdërimet e Allahut qofshin gjithmonë mbi ty! Paqja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e mirë e të çiltër! Dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut. Gjithashtu dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij."

76. Forma e uljes në namaz dhe bërja me shenjë me gishtin tregues në *tesh'heud*. Ashtu siç ka ardhur në hadithin të cilin e transmeton Abdullah bin ez Zubejr (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!) se ka thënë:

"I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), kur ulej në namaz, vendoste dorën e tij të djathtë mbi gjurin e djathtë dhe dorën e tij të majtë mbi gjurin e majtë dhe bënte me shenjë me gishtin e tij tregues."⁶⁰

77. Dërgimi i salavate mbi të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).

((إذا صلى أحدكم فليبدأ بتحميد ربه سبحانه وتعالى، والثناء عليه، ثم يصلي على النبي -صلى الله عليه وعلى آله وسلم-، ثم يدعوا بعد بما شاء))

"Kur ndokush për ju të falet, atëherë le ta filloj namazin e tij duke falënderuar Zotin e tij të Lartësuar dhe duke e lavdëruar Atë. Pastaj le të dërgoj *salavat* mbi Profetin (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e pastaj le të lutet me çfarë të dëshirojë."⁶¹

Forma më e mirë e *tesh'heudit* është ajo që ka ardhur në hadithin të cilin e transmeton Ibën Mesudi el Bedri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!):

اللهم صل على محمد وعلى آل محمد كما صليت على آل إبراهيم، وبارك على محمد وعلى آل محمد كما باركت على آل إبراهيم في العالمين إنك حميد مجيد

"O Zoti im! Dërgo *salavat* mbi Muhamedin dhe familjen e tij, ashtu siç dërgove mbi Ibrahimin dhe familjen e tij! O Zoti im! Bekoje Muhamedin dhe familjen e tij ashtu siç i bekove Ibrahimin dhe familjen e tij! Me të vërtetë Ti je i Lavdërueshmi Lavdiploti ." ⁶²

⁶⁰ E ka nxjerr Muslimi

⁶¹ Ebu Daud dhe hadithi është *sahih*.

⁶² Muslimi

((إذا فرغ أحدكم من التشهد الآخر فليتعوذ بالله من أربع: من عذاب جهنم، ومن عذاب القبر، ومن فتنة المحيا والممات، ومن شر المسيح الدجال))

“Kur ndonjëri prej jush të mbarojë thënien e *tesh’heudit* të fundit, atëherë le të kërkojë mbrojtjen e Allahut prej katër gjërave: Prej dënimit të zjarrit të xhehenemit, prej dënimit të varrit, prej sprovës që vjen gjatë jetës (së përditshme) e vdekjes si dhe prej të keqes së mesihut dexhal.”⁶³

79. Lutjet e gjumit dhe të zgjimit. Transmetohet nga Hudhejfe (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) kur dëshironte që të flinte thoshte:

$$((\begin{smallmatrix}!!!\\...\end{smallmatrix} \begin{smallmatrix}!!\\..\end{smallmatrix} \begin{smallmatrix}!!\\..\end{smallmatrix} \begin{smallmatrix}!\\.\end{smallmatrix} \begin{smallmatrix}!!!!\\....\end{smallmatrix} \begin{smallmatrix}!\\.\end{smallmatrix} \begin{smallmatrix}!!!!!!\\.....\end{smallmatrix} \begin{smallmatrix}!\\.\end{smallmatrix} \begin{smallmatrix}!!\\..\end{smallmatrix}))$$

“Me emrin tënd, o Zoti im, vdes dhe jetoj.”⁶⁴

Dhe kur ngrihej prej gjumit thoshte:

.(!!! !!!!!!! !!!!!!!!!!!!! !!!!!!! !!! !!!!! !!!!! !))

“Falënderimet i takojnë vetëm Allahut, i Cili nga ringjalli pasi na bëri që të vdesim dhe tek Ai do të ringjallemi.”⁶⁵

80. Përmendja e Allahut në fillim të ushqimit.

Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Umer bin Ebi Selemeh se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) i tha atij:

⁶³ Muslimi

⁶⁵ Buhariu

((! !!!!!!! !!●! !!! !!! !!●! !!! !!! !!!!!))

“O djalosh, përmend Allahun, ha me dorën e djathtë dhe ha tek ajo që ke para vetes.”

Dhe pas kësaj, unë nuk kam ngrënë vetëm se në këtë mënyrë që më mësoi i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).⁶⁶

81. Dëmtimi i komshinjve dhe i muslimanëve është haram.

Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Ibën Amër (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

..((!! !!!!!!!! !!! !!! !!! !!! !!! !! !! !!! !! !!))

“Musliman i mirë është ai nga i cili janë të qetë muslimanët prej gjuhës dhe dorës së tij.”⁶⁷

82. Të këshilloj që të jesh i singertë, ngase kjo të shpie në xhenet. Argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

!!!! !!!!! !!●!!! !!!!! !!! !!!!! !! !!!!! !!●!!! !!! !!! !!!!! !!!!! !!●!!!! !!! !!! !!!!! !! !!!!! !! !!!!! !))

..((!!!!!! !!! !!!

“Me të vërtetë, singëriteti të çon te *El Birr*, ndërsa *El Birru* të shpie në xhenet. Kurse gënjeshtria të çon në degjenerim dhe degjenerimi të shpie në zjarr.”⁶⁸

83. Është detyrë për ty respektimi i prindërve, ngase Allahu i Madhëruar ka urdhëruar për këtë gjë në fjalën e Tij:

⁶⁶ Mutefekun alejhi

⁶⁷ Mutefekun alejhi

⁶⁸ Mutefekun alejhi

(وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا)

“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit.” (El Isra 23)

84. Ki kujdes nga përngjasimi me jobesimtarët, ngase Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

.((!!!!!! !!!!!!! !!! !))

“Kush i përngjan një populli, atëherë ai është prej tyre.”⁶⁹

85. Kujdesu që ta përmendësh sa më shumë Allahun e Madhëruar me ato gjëra për të cilën ka argument të saktë, sepse kjo është prej shkaqeve të fitores në dynja dhe në ahiret. Allahu i Madhëruar thotë:

(وَاذْكُرُوا اللَّهَ كَثِيرًا لَّعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ)

“Dhe përmendeni shumë Allahun në mënyrë që të shpëtoni.” (El Xhumua 10)

Transmetohet nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

((كلمتان خفيفتان على اللسان ثقيلتان في الميزان حبيبتان إلى الرحمن: سبحان الله وبحمده، سبحان الله العظيم))

“Dy fjalë janë të lehta për gjuhën, janë të rënda në peshore dhe të dashura tek i Gjithëmëshirshmi: *Subhanallahi ve bihmedihi subhanallahil adhimi.*”⁷⁰

86. Lutja që thuhet në përfundim të tubimit dhe është fshirje për gjynahet.

⁶⁹ Ahmedi etj., prej hadithit të Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

⁷⁰ Mutefekun alejhi

